

**AKT THEMELIMI
(KONTRATË)**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ALLAMAN KURTI-SHPK**

Ne themeluesit :

1.Nevrus KURTI, i biri i Allamanit, lindur me **24.03.1997** në PEJKE/Dibër, banues në Nj.Adm.MELAN/Bashkia/Dibër *Fshati PEJKE-00410018; Nd.83;H.1; Kodi Postar Nr.8303-Pejke/Melan*, zotërues i Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no. J703240100**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

2.Allaman KURTI, i biri i i biri i Ismailit, lindur me **08.01.1967** në PEJKE/Dibër, banues në Nj.Adm.MELAN/Bashkia/Dibër *Fshati PEJKE-00410018;Nd.83; H.1; Kodi Postar Nr.8303-Pejke/Melan*, zotërues i Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no. G70108003L**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Sot me datë **08.09.2022**

V E N D O S E M

Neni 1

Të themelojme një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të EMËRTUAR : **ALLAMAN KURTI-SHPK**

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

Shoqëria e ka SELINË në Njësinë Administrative të qytetit PESHKOPI, Bashkia/Dibër në adresën : *Lagja "Gjok Doçi"; Rruga "Peshkopi-Kukës"; Selia në pasurinë Nr.1/206/3; Z.K.Nr.2932; Kodi Postar Nr.8301/Peshkopi.*

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare dhe t'i suprimojë ato.

Neni 4

Shoqëria do të këtë një kohëzgjatje me një kufi të pacaktuar, **mbi 15 vjet.**


Neni 5

Kapitali Themelor i Shoqërisë do të jetë **1000 Lek (Njëmijë lek) i ndare ne dy pjese (kuota)**

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaket :

Nevrus KURTI qe zotëron **50 %** të vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1 pjesë (Një kuotë)** me vlerë nominale prej **500 Lek (Peseqind lek).**

Allaman KURTI qe zotëron **50 %** të vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1 pjesë (Një kuotë)** me vlerë nominale prej **500 Lek (Peseqind lek).**



Neni 6

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga Ortaku i Vetëm. Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

Neni 7

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Neni 8

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Veprimtari ndërtimore, rikonstruksione dhe mirembajtje në fushën e ndërtimit, përfshirë ndërtime civile, rrugë ura, porte, vepra arti, tunele, ndërtime ushtarake, ndërtime industriale, objekte kulturi, kulturore, sportive, spitale, hotele, banesa, ndërtime hidroteknike dhe turistike, kampingje, parqe rekreative, shtëpi pushimi, palestra, kënde sportive etj. Veprimtari prodhuese të materialeve të ndërtimit, pajisje dhe të makinerive, përfshirë prodhimin e inerteve, rërë, zhavor, konglomerate bituminoze, parafabrikate, konstruksione ndërtimore betonarme, druri metalike, llaç e betone te markave të ndryshme, prodhime gurë gelqere e çakull, prodhime hidrosanitare, prodhime shenjash rrugore, parapetash metalik, si dhe montim riparime dhe mirëmbajtje të makinerive dhe të automjeteve të tipave dhe tonazheve të ndryshme. Veprimtari transportuese ku përfshihet transporti nacional internacional i mallrave dhe i njerzve për vete dhe të tretë, për import eksport. Veprimtari eksportuese dhe importuese ku përfshihet eksporti i lendeve të para dhe i mallrave të përpunuara, si dhe importimi i të gjitha llojeve të mallrave dhe materialeve. Veprimtari tregtare, përfshirë tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore dhe industriale, ndërtimore, elektrike, elektronike bujqësore blektorale, tekstile, hidrosanitare, makineri dhe aparatura, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Veprimtari agrare dhe blektorale përfshirë prodhim bujqësor shfrytëzim pyjesh, prodhim dhe përpunim druri, punime dranazhimi e kanalizime, kultivime të ndryshme etj.

Neni 9

Marëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Ligjit Nr.7961 Dt.12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 10

Ortaku i Vetëm i shoqërisë nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku i Vetëm Themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

Neni 12

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë, midis punonjësve brenda saj dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 13

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit të shoqërisë.

Neni 14

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet pranë shoqërive të sigurimit duke respektuar ligjet që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 15

Organet e Shoqërisë ALLAMAN KURTI SHPK-jane :

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori/ët e Shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.


Administrator i shoqërisë do të jenë **Z. Nevrus KURTI**.

Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga **Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**.

Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin dhe është nënshkruar me vetëdije dhe vullnet të plotë prej meje personalisht.

**THEMELUESI E SHOQËRISË TREGTARE“
ALLAMAN KURTI-SHPK
ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Allaman KURTI.



Peshkopi, me 08 Shtator 2022

Nevrus KURTI.

